

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ETiX Audit & Consultancy” SH.P.K**

Mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Ligjin Nr. 7850, dt. 29.07.1994 “Kodi Civil i RSH”, i ndryshuar, si dhe në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, më datë 08/07/2024, me vullnetin e lirë personat si më poshtë:

- **Znj. Tiziana Xholi**, shtetase Shqiptare, lindur më 24.06.1987, në Durrës dhe banuese në Rr. “Irfan Tomini”, Nd.1844, Ap.135, Tiranë, identifikuar me Nr. Personal I75624085G, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, dhe
- **Z. Elton Tirana**, shtetas Shqiptar, lindur më 24.02.1974, në Tiranë dhe banues në Rr. “Medar Shtylla”, Nd.47, Ap.8, Tiranë, identifikuar me Nr. Personal H40224146M, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

kanë hartuar Aktin e Themelimit të një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni Shqiptar në fuqi, nga ky Akt Themelimi dhe Statuti.

Neni 1 - Emërtimi

Shoqëria është emërtuar **“ETiX Audit & Consultancy” Sh.p.k.**

Shoqëria do të organizohet si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (Sh.p.k).

Neni 2 – Selia

Selia e Shoqërisë është në adresën Rruga “Muhamet Gjollesha, Njësia Administrative nr. 7, Zona Kadastrale 8250, Nd.2/834-ND, Tiranë.

Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose filiale brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 3 – Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është për një afat të pacaktuar.

Neni 4 – Objekti i Shoqërisë

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Kryerja e Shërbimeve të auditimit dhe e shërbimeve të tjera të dhënes së sigurisë, të shërbimeve të lidhura, sipas përcaktimit të këtyre shërbimeve të dhëna nga IFAC;
- Shërbimet e mbajtjes së kontabilitetit, deklarimeve tatimore dhe hartimi i pasqyrave financiare, rivlerësim aktivitetesh e asetesh;
- Përgatitja e raporteve periodike financiare sipas nevojave të drejtuesve të biznesit, të tilla si raporti i ecurisë së veprimtarisë, raporti i drejtimit të brendshëm, planeve të biznesit, raportet e kostos, etj.;
- Këshillim ekonomik, financier dhe fiskal, dhe këshillim biznesi mbi mundësitet e zhvillimit;
- Këshillim dhe asistencë për regjistrimin e një aktiviteti tregtar, këshillim fiskal për njojen dhe zbatimin e ligjislacionit fiskal;
- Shërbime të tjera të lidhura me shoqëritë tregtare, si: ndarje, bashkim, përvitje, transferim, administrim, likujdim, falimentim; rritje dhe zvogëlim kapitali; hetime të posacme, përfaqësim në çështje gjyqësore që kërkojnë ekspertizë kontabile ose fiskale, tregtare, dhe ekonomike;



- Ngritja, përmirësimi dhe mirëmbajtja e sistemeve kontabël dhe të kontrollit të brendshëm të njësive ekonomike si dhe trajnimin profesional të personelit që është i ngarkuar me funksionimin e këtyre sistemeve;
- Organizimin e kurseve të trajnimit profesional në fushën e kontabilitetit, financës dhe legjislacionit tatum;
- Hartim, zbatim, implementim dhe monitorim i projekteve të ndryshme;
- Shoqëria mund të kryejë çdo shërbim tjetër të pajtueshëm me profesionin e Audituesit Ligjor duke përjashtuar çdo veprimitari që bie në kundershtim me Ligjin Nr.10 091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistik të miratuar", i ndryshuar.

Neni 5 – Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 (Njëqind mijë) Lekë dhe është i ndarë në 2 kuota, të cilat i përkasin ortakëve si më poshtë.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre si vijon:

1. **Znj. Tiziana Xholi** me vlerë 50.000 (Pesëdhjetë mijë) Lekë, e cila përbën 50% të kapitalit të shoqërisë;
2. **Z. Elton Tirana** me vlerë 50.000 (Pesëdhjetë mijë) Lekë, e cila përbën 50% të kapitalit të shoqërisë.

Shoqëria mund të shtojë ose zgjedh të kufirin e përcaktuar me ligj, me vendim të Asamblesë së Aksionarëve. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 6 – Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- Shitblerjes;
- Trashëgimisë;
- Dhurimit;
- Çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, ose tek personat e tretë me miratimin e Asamblesë së Ortakëve.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 7 – Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë, që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Kompetencat e Aksionarëve rregullohen në Statutin e Shoqërisë.

Neni 8 – Administratori

Me këtë Akt emërohet Administrator i Shoqërisë:

- **Znj. Tiziana Xholi**, shtetase Shqiptare, lindur më 24.06.1987, në Durrës dhe banuese në Rr. "Irfan Tomini", Nd.1844, Ap.135, Tiranë, identifikuar me Nr. Personal I75624085G, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.



Afati i emëritimit të Administratorit është për një periudhë 5-vjeçare duke filluar nga data e emëritimit nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve.

Kompetencat e Administratorit rregullohen në Statutin e Shoqërisë.

Neni 9 – Personaliteti juridik dhe veprimtaria e Shoqërisë

Personalitetin juridik Shoqëria e fiton në momentin e regjistrimit të saj si person juridik në regjistrin tregtar pranë QKB-së, ndërsa të drejtën për të vepruar sipas objektit të saj Shoqëria e fiton në momentin e marrjes së lejes për ushtrimin e veprimtarisë nga organet tatimore. E gjithë veprimtaria e Shoqërisë do ë zhvillohet në bazë të Aktit të Themelimit, Statutit të Shoqërisë dhe dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi.


Neni 10 – Legjislacioni

Përsa nuk është shkruar në këtë Akt Themelimi dhe në Statut, legjislacioni i zbatueshëm do të jetë Legjislacioni tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.


Neni 11 – Efektet

Efektet e këtij Akti nisin që nga momenti i nënshkrimit të tij.

**O R T A K Ë T
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ETiX Audit & Consultancy” SH.P.K**



(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)



(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)